

VENDIM
Nr. 276, datë 9.5.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 689, DATË 23.10.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË
PROCEDURAVE TË SHPALLJES SË KURORËS SË GJELBËR DHE PËRCAKTIMIN
E RREGULLAVE E TË PËRGJEGJËSIVE NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN,
MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 689, datë 23.10.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 8, të kreut II, emërtimi “Këshillit Kombëtar të Territorit” zëvendësohet me “Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU)”.

2. Pas kreut II shtohet kreu II/1, me këtë përmbajtje:

“II/1. Veprimtaritë e ndaluara dhe të lejuara në kurorën e gjelbër

1. Veprimtaritë e ndaluara janë:

a) kultivimi, mbarështimi i specieve invazive, të cilat mund të dëmtojnë zinxhirin ekzistues të botës së gjallë të zonës së mbrojtur;

b) fragmentimi i habitateve;

c) gjuetia;

ç) grumbullimi i kafshëve të egra, përveç rasteve me qëllim kërkimor-shkencor;

d) mbjellja e llojeve monokulturë (në pyllëzime).

2. Veprimtaritë e lejuara në kurorën e gjelbër janë veprimtaritë e lejuara për zonat e mbrojtura, “Kategoria V”, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, si dhe veprimtaritë e mëposhtme:

a) Veprimtaritë kërkimore-shkencore;

b) Veprimtaritë me qëllim edukimin mjedisor;

c) Veprimtaritë me qëllim monitorimin e gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;

ç) Çdo veprimtari që lidhet me ndërhyrjet e nevojshme ose urgjente për përmirësimin e biodiversitetit, rigjenerimit ose shëndetësimit ose çdo veprimtari tjetër për këtë qëllim;

d) Veprimtaritë e zhvilluara në struktura miqësore me biodiversitetin e mjedisin;

dh) Veprimtaritë e zhvilluara në struktura akomoduese të turizmit/agroturizmit dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse;

e) Veprimtaritë ekonomike, shoqërore, për ndërtimin e strukturave miqësore me biodiversitetin me qëllim vërtetimi në natyrë, kamping, njësi shërbimi, për qëllime shëndetësore;

ë) Instalimet për veprimtari të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe të transmetimit e të shpërndarjes së energjisë;

f) Ndërtimi i mënyrave të transportit miqësore me biodiversitetin, si: shtigje biçikletash, shtigje për ecje;

g) Ndërhyrjet e lejuara urbane, rekreacioni apo ekonomike brenda zonës, duke ruajtur karakterin e saj;

gj) Veprimtaritë bujqësore-blegtorale, pylltari, kullotje;

h) Veprimtaritë, që kanë të bëjnë me operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin/ndërtimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave;

i) Ekoturizmi;

j) Veprimtaritë kulturore;

k) Veprimtaritë, të cilat inkurajojnë komunitetin lokal në mirëmbajtjen e zonës;

l) Veprimtaritë e tilla, si: ndërtime, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, ndërtimi i kanaleve lundruese, autostradave, zonave urbane, investime strategjike, si dhe veprimtaritë e ngjashme me këto, nëse subjekti që kërkon të kryejë veprimtarinë është i pajisur me leje nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit;

ll) Veprimtaritë ushtarake, të cilat mund të ushtrohen pas miratimit me shkrim/pajisjes me leje mjedisi;

m) Çdo veprimtari tjetër, në përputhje me planin e integruar të menaxhimit të zonës së mbrojtur.”.

3. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda kurorës së gjelbër, miraton me rregullore të posaçme kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi për veprimtaritë/projektet, që lidhen me veprimtaritë e lejuara, të parashikuara në kreun II/1 të këtij vendimi, si dhe rregullat e kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse.”.

b) Në pikën 2, shkronjat “ç” dhe “d” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ç) ndalon kryerjen e ndërhyrjeve dhe të veprimtarive në kurorë, të cilat nuk janë në përputhje me parashikimet e planit të menaxhimit, me përjashtim të rasteve kur ka një vendimmarrje me rregullore të posaçme për leje zhvillimi/ndërtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit. Miratimi me rregullore të posaçme i rregullave dhe i kriterëve teknike të zhvillimit/ndërtimit nga ana e KKTU-së konsiderohet akt i ndryshimit;

d) merr masat e nevojshme për pezullimin apo kufizimin e të gjitha veprimtarive që cenojnë qëllimin dhe objektivat e menaxhimit, me përjashtim të rasteve kur ka një vendimmarrje me rregullore të posaçme për leje zhvillimi/ndërtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit. Miratimi me rregullore të posaçme i rregullave dhe kriterëve teknike të zhvillimit/ndërtimit nga ana e KKTU-së konsiderohet akt i ndryshimit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku